

16.02.2022
Ora 16:03

RENDI I DITËS

*Projektvendim “Për rishqyrtimin e kërkesës së subjektit zgjedhor “Lëvizja e Re”
për regjistrimin e kandidatit për kryetar në bashkinë Durrës, zoti Jonid Robert
Nano, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”.*

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Illirjan Celibashi**
2.Stafi KQZ: **Y.Merkaj, M.Koja, E.Allushi**
- **Parti Politike:** **LRE (A.Galdini, J.Nano)**

Z. I. Celibashi: Mirëdita! Fillojmë seancën publike për shqyrtimin e dy çështjeve sot në rendin e ditës. Çështja e parë ka të bëjë me projektvendimin “Për miratimin e disa vëzhguesve për zgjedhjet e pjesshme të 6 Marsit 2022” dhe pika e dytë ka të bëjë me “rishqyrtimin e kërkesës të subjektit zgjedhor Partia Lëvizja e Re për regjistrimin e kandidatit për kryetar të Bashkisë Durrës, zoti Jonid Robert Nano”. Atëherë, po fillojmë me shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e subjektit zgjedhor dhe pastaj vazhdojmë me pikën tjetër që ka të bëjë me regjistrimin e vëzhguesve për këto zgjedhje. Mirë, atëherë kemi prezent këtu dhe përfaqësuesin dhe kryetarin e Partisë Lëvizja e Re. I japim fjalën kryetarit të partisë, ose përfaqësuesit për të paraqitur pretendimet e tyre në lidhje me këtë çështje. Sikurse e dini, KAS vendosi që të prishë vendimin e Komisionerit për të mos regjistruar kandidatin e Partisë Lëvizja e Re, si kandidat për kryetar të Bashkisë Durrës. Tani jemi në proces rishqyrtimi, vendosim një afat 24 orë për të bërë plotësimin e dokumentacionit

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.16.02.2022*

përkatës, duke sjellë 1% të firmave mbështetëse, ose 1 dokument tjetër të vlefshëm sipas ligjit. Po, fjala është për ju!

Z. A. Galdini, kryetar i Partisë LRE: I nderuar zoti kryetar! Të nderuar zonja dhe zotërinj të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve! Jemi në një realitet ligjor dhe politik që besoj që ka shumë rëndësi që të shihet me vëmendje dhe me seriozitet të thellë nga ju, për shkak se në vitin 1990 shqiptarët fituan pluralizmin politik. I gjithë populli shqiptar u ngrit për të rrëzuar sistemin njëpartiak, në mënyrë që të triumfonte e drejta dhe mundësia për të zgjedhur përfaqësuesit mes shumë partive, shumë ideve dhe shumë alternativave. Ajo që ka ndodhur në 31 vite është që demokracia, liria dhe e drejta e shqiptarëve për të zgjedhur përfaqësuesit e tyre ka filluar dhe është kufizuar taktikisht, institucionalisht, por dhe ligjërisht nga 3 partitë dominuese në këto 31 vite. Një nga elementet bazë që në fakt dëshmon se ka pluralizëm politik është e drejta për të konkurruar. E drejta e garës. Dhe jo vetëm thjesht e drejta e garës, por e drejta për të garantuar barazi, liri dhe ndershmëri në garë. Tre partitë kryesore që kanë dominuar në këtë 31-vjeçar kanë zaptuar të gjitha institucionet dhe kanë krijuar një regjim tripalësh prej nga ku këto 3 parti kanë kapur legjislativin, ekzekutivin, por edhe organet kushtetuese, përfshirë dhe këtë institucion, sepse kemi ndërtuar institucione të tilla të ngjashme me asgjë tjetër në asnjë vend të botës, sepse kemi 3 parti që janë edhe konkurruese, edhe emëruese të arbitrave, apo të rregullatorëve, të administratorëve, të procesit zgjedhor, por njëkohësisht janë dhe gjykues dhe përcaktues se kush do të jetë konkurrent dhe kush do të jetë përballë tyre në këtë garë politike apo në cilëndo garë politike. Është parlamenti që vendos përfaqësuesit e PS, PD, LSI për të qenë drejtues dhe anëtarë të KQZ-së. Janë PS, PD, LSI që përcaktojnë se kush do të jenë anëtarët e KAS-it. Janë PS, PD, LSI që vendosin se kush do të jenë dhe anëtarët e Kolegjit Zgjedhor, dhe praktikisht çdo


*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.16.02.2022*

parti tjetër, e cila synon të hyjë në proceset zgjedhore, synon të konkurrojë, duhet të kalojë patjetër nën këtë ngushticë të këtyre 3 partive, apo këtij regjimi tripalësh. Nëse Lëvizje e Re, kemi ardhur duke zbatuar çdo afat, çdo procedurë ligjore, të ndërgjegjshëm se jemi një parti institucionale dhe duhet t'u qëndrojmë këtyre parimeve që kërkon institucionalizmi. Afatet që jepen nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve janë afat për të ndihmuar procesin e partive dhe të kandidatëve në regjistrim. Ajo që ka ndodhur është se Lëvizjes së Re, i janë mohuar garancitë procedurale në momentin që ka dorëzuar dokumentacionin për kandidatët e saj, sidomos në këtë rast është epik rasti i kandidatit tonë për kryetar Bashkie në Durrës, zoti Jonid Nano, sepse absolutisht nuk është komunikuar me asnjë person, me asnjë institucion të partisë tonë nga KQZ-ja prej askujt. Madje ndryshe nga sa e parashikon ligji, KQZ-ja në vend që t'i drejtohej me shkresë, sepse Kodi detyron KQZ-në që t'i drejtohet me shkresë partisë konkurruese, KQZ-ja i është drejtuar me shkresë një institucioni tjetër, pra Këshillit Bashkiak të Durrësit, që është një tjetër shkelje. Pse e them këtë gjë? Sepse unë mendoj që këtu kemi të bëjmë me vendim politik, nuk kemi të bëjmë me vendim ligjor. Unë mendoj që për shkak të natyrës sesi është krijuar Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe KAS-i, dhe këtu ka një paradoks dhe një ironi tjetër, sepse KAS-i është një tjetër institucion *suigeneris*, i cili është në varësinë e KQZ-së është i stacionuar në KQZ dhe duhet të gjykojë vendimet e Komisionerit. Pra, jemi në një nonsens logjik dhe ligjor dhe në vijimësi kemi nga administrata e KQZ-së deri tek vendimi i marrë për përjashtimin e Jonid Nanos, si kandidat, e më tej deri tek vendimi i KAS-it, të njëjtën sjellje politike jointitucionale. Vendimi i KAS-it për ne e përmbylli këtë bindje dhe këtë qartësi, se këtu bëhet fjalë për vendim politik, sepse zotërinjtë e KAS-it praktikisht u tallën me një konkurrent në garën elektorale për zgjedhjet e pjesshme të 6 marsit, por më vjen keq të them që janë tallur me institucionin tuaj. KAS-i kishte dy mundësi, ose


*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.16.02.2022*

të pajtohej me vendimin e Kryekomisionerit, ose ta rrezonte vendimin e Kryekomisionerit. Vendimi i KAS-it që na jep 24 orë, pra na rikthen garancitë procedurale të mohuara në kohën e duhur para 7 ditësh, në fakt është një tejmoshmim i të drejtave tona për të qenë të trajtuar si të barabartë institucionalisht dhe ligjërisht nga ky institucion. Është një lloj si t'i thuash dikujt, më ka humbur portofoli para 7 ditësh, ti shkon në polici, policia s'bën asgjë, shkon në prokurori por prokuroria s'bën asgjë dhe kur shkon në gjykatë, gjykata thotë, kthehu prapë tek një vend ku ke qenë para 7 ditësh se ndoshta hajduti ta risjell portofolin. Pra, nuk mund t'ia rijapësh garancinë procedurale një partie, të mohuar, mbas 7 ditësh. Pra, ka tallje, ka shkelje ligjore, ka cinizëm, dhe unë mendoj që këtu duket qartë vendimi politik i KAS-it, dhe qëndrimi politik i KAS-it. Gjëja tjetër që unë dua t'ju them, që dua t'ju tërheq vëmendje dhe t'ju bëj thirrje për ta marrë në konsideratë, është zoti kryetar, se një garanci procedurale e mohuar është drejtësi e mohuar. Pra, në këtë rast ne na është mohuar e drejta dhe për më tepër akoma një garanci procedurale e dhënë me një javë vonesë është garanci procedurale, jo thjesht e vonuar, jo drejtësi e mohuar, por është dhe drejtësi e tallur. Prandaj, si një parti politike, e cila e sheh pluralizmin jo tek shumësia e partive politike, por tek liria, barazia dhe ndershmëria e garës, ne ju kërkojmë që të na riktheni të drejtën për të pasur kandidatin tonë në garën për Bashkinë e Durrësit. Nuk po kërkojmë as më shumë dhe as më pak, vetëm atë për të cilën shqiptarët u ngritën në 90'-ën, të drejtën e garës, të drejtën e mundësisë së garës. Nuk po kërkojmë privilegj, nuk po kërkojmë favor, nuk po kërkojmë absolutisht asgjë të paligjshme në këtë histori, po kërkojmë që duke qenë se brenda këtij institucioni kemi një vendim, i cili tashmë është zyrtar, pra, i njëjti kandidat i Lëvizjes së Re, absolutisht me të njëjtën dosje, absolutisht me të njëjtën dinamikë ligjore, absolutisht me të njëjtën procedure, me firmën time dhe me vulën time, është regjistruar nga KZAZ-ja dhe pastaj është ratifikuar nga KQZ-ja. Ne mendojmë që

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.16.02.2022*

ky precedent është i mjaftueshëm për të ndjekur po të njëjtën udhë për miratimin e kandidatit tonë, Jonid Nano. Gjëja tjetër që dua t'ju them është që duke qenë se kemi një precedent të vendosur për po këto zgjedhje, nga po ky institucion, sepse KAS-i ka bërë një tjetër tallje. KAS-i pretendon se KZAZ-ja e Dibrës është institucion në Republikën e kush e di kujtit, që funksionon me një tjetër kod elektoral të Republikës së ku di kujtit dhe nuk funksionon si një institucion i varësisë së KQZ-së. Pra, KAS-i është tallur, ka mbajtur një qëndrim tallës, nuk ka mbajtur fare qëndrim as juridik, as institucional. Prandaj ju them, ju lutem merreni në konsideratë, sepse kemi garanci proceduriale të mohuara, pra drejtësi të mohuar. Kemi një rast të ngjashëm që është për po këto zgjedhje, nga po e njëjta parti, njëri kandidat është regjistruar, ndërsa tjetrit i refuzohet e drejta për t'u regjistruar. Dhe për pikën 3, gjëja e fundit që dua t'ju them është se po, ne mund ta kishim plotësuar, por mos harroni dhe merrni në konsideratë sepse ligji dhe procedurat parashikojnë gjithmonë sipas së drejtës edhe në rastet e jashtëzakonshme. Dekreti presidencial ka ardhur papritmas, ku asnjë aktor politik dhe asnjë parti politike konkurruese nuk ka qenë në dijeni dhe nuk ka qenë e informuar për mundësinë e ndodhjes së këtyre zgjedhjeve. Pra, praktikisht edhe nëse ne do donim të kishim kryer procedurën ligjore për posedimin e atij mandati, në emër të Lëvizjes së Re, ne praktikisht e kemi patur të pamundur, prandaj ne konsiderojmë që vetëdeklarimi i këshilltares ku ajo mbështet kandidatin tonë për kryetar bashkie, e lidh këshilltaren politikisht me Lëvizjen e Re, sepse i jep shans për të konkurruar dhe për rrjedhojë edhe mundësinë për të fituar kandidatit të Lëvizjes së Re. Çdo vendim që do të merrni sot, unë mendoj që është një vendim që merret pro ose kundër pluralizmit politik. Çdo vendim që do të merrni sot, mendoj që do të cenojë lirinë dhe barazinë e garës. Shqipëria duhet të shkëputet njëherë e mirë nga 3 parti që vendosin edhe të konkurrojnë, edhe të gjykojnë, edhe të arbitrojnë, pra duhet njëherë e mirë që të çlirojnë këto institucione nga partitizmi,

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.16.02.2022*

sidomos nga regjimi tripalësh. Lëvizja e Re do të qëndrojë këtu dhe do ta keni këtu dhe për shumë vite, siç po e shohim këto ditë, ju siguroj që do ta shikoni dhe për shumë vite këmbëngulëse dhe konkurruese. Ne nuk arrijmë ta kuptojmë dot se një parti politike mund të ekzistojë pa ushtruar të drejtën e saj për të konkurruar. Prandaj, ju bëj thirrje për një vetëdijësim ligjor, institucional, por dhe demokratik që ta rishqyrtoni vendimin tuaj dhe ta konsideroni edhe pikën 3, si një pikë në rast të jashtëzakonshëm dhe t'i paketoni së bashku rastin e ngjashëm me kandidatin e Dibrës dhe mohimin e garancive procedurale që na është bërë nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Po, faleminderit zoti Galdini për të gjithë prezantimin dhe narrativën tuaj në lidhje me këtë çështje. E vlerësoj atë, por duhet të mirëkuptoni pozicionin e institucionit të KQZ-së, dhe në mënyrë të posaçme në këtë moment Komisionerin Shtetëror, sipas të cilit, këtij pozicioni, do duhet që vlerësimi në lidhje me këtë çështje do të bëhet thjesht dhe vetëm në përputhje me parashikimet e Kodit Zgjedhor. Tashmë, në kushtet kur ne nuk mundet të japim një afat tej atij afati, të cilin e ka përcaktuar KAS në vendimin e vet për të prishur vendimin e parë të Komisionerit Shtetëror, dhe në kushtet kur në vlerësimin tonë mungon dokumentacioni që do ta kualifikonte kandidatin tuaj, me gjithë respektin për të dhe për partinë tuaj, si kandidat për këto zgjedhje, më duhet të them që jemi në kushtet e mosregjistrimit të kandidatit për kryetar në Bashkinë Durrës, zotit Jonid Robert Nano, të propozuar nga subjekti zgjedhor Lëvizja e Re, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar të bashkive, të datës 6 Mars 2022.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe do të publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.16.02.2022*

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 24 orëve nga data e shpalljes së këtij vendimi, në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve. Faleminderit për mirëkuptimin!

Vendimi nr. 79

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



16.02.2022
Ora 16:20

RENDI I DITËS

Projektvendim "Për shqyrtimin e kërkesës së Shkodra Web, Albanian Post, TV Ora News, agjencisë Light Studio Agency, TV Vizion Plus, për vëzhgimin e zgjedhjeve të pjesshme për kryetar bashkie, të datës 6 Mars 2022".

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Ilirjan Celibashi**
 - 2.Stafi KQZ: **Y.Merkaj, M.Koja, E.Allushi**
- **Parti Politike:** **S'ka**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin e kërkesave për miratim vëzhguesish.

Z. Y. Merkaj: Shkodra Web i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën dhe dokumentacionin për akreditimin e 4 gazetarëve dhe operatorëve, si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Albanian Post ka paraqitur kërkesën dhe dokumentacionin për akreditimin e 11 gazetarëve dhe operatorëve, si dhe zonat e vëzhgimit të tyre, Ora News ka paraqitur kërkesën për akreditimin e 69 gazetarëve dhe operatorëve, Light Studio Agency ka paraqitur kërkesën për 5 përfaqësuesit, si dhe zonën e vëzhgimit të tyre, dhe Vizion Plus ka paraqitur kërkesën për akreditimin e 80 gazetarëve dhe operatorëve, si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Kërkesat nga këto media janë në respektim të afatit të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodi Zgjedhor, dhe të gjitha subjektet gëzojnë të drejtën të caktojnë vëzhgues në zgjedhjet për

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.16.02.2022*

organet e qeverisjes vendore të datës 6 Mars 2022. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Mirë, atëherë i miratojmë të gjitha kërkesat, duke vendosur akreditimin si vëzhgues për vëzhgimin e zgjedhjeve të pjesshme për kryetar bashkie, të datës 6 Mars 2022, të katër gazetarëve dhe operatorëve të medias Shkodra Web, të 11 gazetarëve dhe operatorëve të Mediumit Online Albanian Post, të 69 gazetarëve dhe operatorëve të TV Ora News, të pesë përfaqësuesve të agjencisë Light Studio Agency, të 80 gazetarëve dhe operatorëve të televizionit Vizion Plus. Çështje të tjera për rendin e ditës nuk kemi. Mirë, seanca mbyllet, faleminderit!

Vendimi nr. 78

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*

